

Në bazë të nenit 14 paragrafi 2 dhe 3, nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune – tekst i pastruar (Gazeta Zyrtare e RM nr. 167/2015), nenit 20-g të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 27/14 dhe 199/14), ndërsa në lidhje me Mendimin e pranuar pozitiv të Planit vjetor për punësim për vitin 2017 me nr. 12/6-2060/11 të datës 18.12.2017, NP “Parqet dhe gjelbërim” – Shkup publikon

SHPALLJE PUBLIKE nr. 01/2017

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për kohë të pacaktuar të punës

1. NP “Parqet dhe gjelbërim” – Shkup ka nevojë për punësim të:

Nr. rend	Shifra	Titulli vendit të punës	Nr. i realizuesve
1	KDR.04.03.A01.001	Vozitës i drejtorit	1
2	KDR.04.03.A02.002	Vozitës të makinës	1

2. Marrëdhënia e punës për të gjitha vendet e punës është për kohë të pacaktuar të punës.

3. Marrëdhënia e punës është me orar të plotë të punës.

4. Secili kandidat duhet të përmbushë kushtet e përgjithshme në vijim:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
- Në mënyrë aktive të njeh gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik
- Të jetë i moshës së rritur
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

5. Kandidatët të cilët do të paraqiten për vendet e punës me numër rendor 1 dhe 2 duhet të përmbushin kushtet e posaçme sipas LMP ose Marrëveshjes kolektive për veprimtari komunale dhe kushtet e përcaktuara në Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në NP “Parqet dhe gjelbërim” – Shkup; gjegjësisht

Kushtet e posaçme të caktuara me Ligjin për ndërmarrjet publike dhe LMP ose Marrëveshjen kolektive për veprimtari komunale për të gjithë personat ndihmës-teknik për të gjitha kategoritë janë:

Kualifikimet profesionale:

- person ndihmës-teknik të nivelit të parë (A1), me nivel më të ulët të kualifikimit IV, 240 kredi sipas ECVET ose MKSOO ose arsim të mesëm katërvjeçar,
- person ndihmës-teknik të nivelit të dytë (A2), me nivel më të ulët të kualifikimit III, 180 kredi sipas ECVET ose arsim të mesëm trevjeçar dhe

Përvojë pune, edhe atë:

Për nivelin A1 së paku dy vjet përvojë pune

Për nivelin A2 së paku një vit përvojë pune;

Kusht tjetër i posaçëm për vendin e punës me numër rendor 1 dhe 2 është edhe posedimi i kategorisë B.

6. Orari i punës është pesë ditë pune në javë (prej ditës së hënë deri ditën e premte) dhe do të jetë prej ora 7 deri në ora 15.

7. Neto pagesa themelore për vendin e punës me nr 1 është 19.355,00 denarë për orar të plotë të punës, ndërsa neto pagesa themelore për vendin e punës me nr. 2 është 18.865,00 denarë për orar të plotë të punës;

8. Kandidatët për punësim paraqiten në shpalljen publike përmes plotësimit të fletëparaqitjes. Fletëparaqitjen për punësim kandidatët mund ta marrin në zyrat e ndërmarrjes publike ose në ueb faqen www.parkovi.com.mk

9. Me fletëparaqitjen kandidatët për të gjitha vendet e punës duhet të parashtrojnë

- Biografi të shkurtë
- Dëshmi për arsim të mbaruar (diplomë origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
- Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
- Dëshmi se nuk i është shqiptuar dënim për ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)

10. Në pajtim me Planin vjetor për punësim në institucion për vitin 2017, punësimet janë paraparë: 2 (dy) të nacionalitetit shqiptar.

11. Fletëparaqitjet së bashku me bashkëngjitjet dorëzohen personalisht në ndërmarrjen publike ose përmes postës në adresën NP “Parqet dhe gjelbërimet” – Shkup rr. “Ilinden” nr. 104; 1000 Shkup.

Kontakt tel. 02/3070 112 e-mail: covecki.resursi@parkovi.mk.com

Shpallja zgjatë 5 ditë duke konsideruar nga dita e publikimit në shtypin ditor.

Fletëparaqitjet e dorëzuara pas afatit, jo të plota dhe të parregulluara nuk do të jenë lëndë shqyrtimi.

NP Parqet dhe gjelbërim
UD drejtor, Ardijan Muça